



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE FISKALE

AVOKATI I TATIMPAGUESIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 31.1.2024

RAPORT

MBI

VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË AVOKATIT TË TATIMPAGUESIT PËR VITIN 2023

Në zbatim të nenit 105/2, të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 28.7.2010, “Për Avokatin e Tatimpaguesit”, të ndryshuar, si dhe pikës 5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 25.2.2019, “Për funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Tatimpaguesve, procedurat që do të zbatohen prej tij në mbrojtje të interesave të tatimpaguesve, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga avokati i tatimpaguesve”, të ndryshuar, Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, në ushtrim të funksionit dhe në fushën e vetë të përgjegjësisë, paraqet këtë raport mbi veprimtarinë e saj për vitin 2023.

I. Misioni i Avokatit të Tatimpaguesit

Avokati i Tatimpaguesit mbron interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatimore. Ai autorizohet të investigojë të gjitha kërkesat apo ankesat e tatimpaguesve që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektim të procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë.

Në kryerjen e misionit të tij ligjor Avokati i Tatimpaguesit ka autoritetin që:

- të kërkojë informacion dhe sqarime nga të gjithë punonjësit e administratës tatimore;
- të urdhërojë Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT) për evidentimin e informacioneve dhe për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve të veçantë apo grupeve të tatimpaguesve;
- të urdhërojë Drejtorinë Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për të shqyrtuar procedura të caktuara të administrimit tatimor;
- të rekomandojë përmirësimin e procedurave tatimore, dhe po të jetë rasti edhe ndryshime në legjislacionin tatimor apo Kodin e Etikës së Administratës Tatimore;
- të referojë raste të veçanta në DPT, përkatësisht në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor ose Drejtorinë e Hetimit Tatimor, nëse informacioni apo dokumentacioni lidhur me një ankesë konkrete nga tatimpaguesi tregon se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo hetimit tatimor;

- të referojë raste të veçanta tek Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ose Drejtoria e Investigimit të Brendshëm, nëse informacionet e administruara nga Avokati i Tatimpaguesit, në mënyrë të përsëritur, i referohen sjelljeve të papërshtatshme të punonjësve/inspektorëve të caktuar apo keqpërdorimit të procedurave, sistemeve dhe autoritetit zyrtar prej tyre, duke treguar se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të kontrollit apo investigimit të brendshëm për ata punonjës të administratës tatimore apo në procedurat e sistemet përkatëse;
- të propozojë masa disiplinore për punonjësit të cilët nga analizimi i rasteve të shqyrtuara prej tij, rezultojnë se nuk respektojnë procedurat apo i shkelin ato me dashje, megjithëse përgjegjësia kryesore për propozime të tilla i takon drejtorëve rajonalë ose funksionalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

II. Varësia strukturore dhe vendimmarrja

1. Varësia strukturore administrative

Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit është strukturë në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Fiskale, në Ministrinë e Financave.

2. Vendimmarrja

Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit është strukturë e pavarur në vendimmarrje, për çështjet në shqyrtim që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesve.

III. Veprimtaria e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit për vitin 2023

Veprimtaria e Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit për vitin 2023, mund të përmbledhet në informacionin me të dhënat si më poshtë evidentohen:

1. Praktikat e trajtuara gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023, janë trajtuar gjithsej në rrugë shkresore dhe elektronike **424** praktika. Këto praktika i janë drejtuar direkt Avokatit të Tatimpaguesit, ose janë përcjellë nga Drejtori i Përgjithshëm. Në këtë numër përfshihen dhe praktikrat e ardhura nga Zyra e Bashkëqeverisjes. Nga praktikrat e përcjella në rrugë elektronike në adresën e Avokatit të Tatimpaguesit, një numër i konsiderueshëm i kërkesave të paraqitura, pas klasifikimit dhe vlerësimit të objektit të tyre, kanë konsistuar, në kërkesa për dhënie asistence, ndihme dhe orientimi të tatimpaguesve në strukturat përgjegjëse të administratës tatimore, sipas objektit të kërkesës. E njëjta procedurë është ndjekur edhe me praktikrat shkresore, duke u përpjekur që të synohej zgjidhja e problematikave të shprehura në përmbajtjen e tyre, si nga Avokati i Tatimpaguesit, ashtu dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Fiskale për rastet e përcjella nga Drejtori i Përgjithshëm, (jashtë kompetencës së Avokatit të Tatimpaguesit), duke deleguar problematikën për trajtim dhe/ose kompetencë në strukturat kompetente brenda Ministrisë së Financave apo në institucionet e varësisë së saj, në varësi të fushës së përgjegjësisë për trajtim. Në vijim gjeni të dhëna të detajuara mbi kërkesat/ankesat e paraqitura.


A. Të dhënat mbi ankesat/kërkesat e tatimpaguesve të trajtuara në rrugë shkresore, Drejtuar Avokatit të Tatimpaguesit:


a) Ankesa/kërkesa për shqyrtim të ardhura gjithsej raste nga këto:

46

i. Të pranuar	26
ii. Të refuzuara	20
a.1) Nga rastet e pranuar:	
i. Çështje të mbyllura	24
nga këto:	
i/a. Të zgjidhura	16
i/b. Të pazgjidhura	8
ii. Çështje të pambyllura (në proces)	2
a.2) Përqindja e atyre që janë të vjetra	0%
b) Kërkesa/ankesa jo në kompetencë të Avokatit të Tatimpaguesit	18
c) Urdhra për shqyrtim të çështjeve lëshuar për organet tatimore	23
nga këto:	
c.1) Çështje të mbyllura	23
c.2) Çështje në proces	0
nga këto:	
- Përqindja e atyre që janë të vjetra	0%
c.3) Urdhra për shqyrtim të çështjes, që kanë gjetur zgjidhje në favor të tatimpaguesit	16
ç) Urdhra për rishikim procedural	1
nga këto:	
- Numri i vendimeve përfundimtare të mbështetur nga DPT te rekomandimi i dhënë nga Avokatit të Tatimpaguesit për zgjidhjen e çështjes	0
- Numri i çështjeve për të cilat nuk janë gjetur zgjidhje, por që janë dhënë rekomandime për DPT për gjetjen e zgjidhjeve të mundshme	8
d) Numri i herëve që Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve i është kërkuar të japë një vendim përfundimtar deri në atë masë sa rezultati është mbështetur nga pozicioni i Avokatit të Tatimpaguesit	1

B. Të dhëna përmbledhëse në mënyrë grafike mbi rastet e trajtuara në rrugë shkresore, nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit





Theksojmë se për *raste të veçanta të pazgjidhura*, në përfundim të shqyrtimit të tyre, në vlerësim edhe të qëndrimeve të dhëna nga administrata tatimore, Avokati i Tatimpaguesit ka dhënë vlerësimin përfundimtar, duke sugjeruar edhe rekomandime të veçanta për zgjidhjen e tyre, sipas rastit.

Gjatë këtij viti, kërkesat e tatimpaguesve janë depozituar në rrugë shkresore zyrtare dhe në rrugë elektronike, ku numri total vjetor ka arritur **në 424**, nga të cilat komunikime elektronike 296 dhe praktika shkresore 128.

C. Komunikimet elektronike

Gjatë vitit 2023 në adresën e postës elektronike të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit u paraqitën **296** e-maile me problematika të ndryshme, nga të cilat u morën në shqyrtim brenda kompetencës dhe fushës së përgjegjësisë **26** prej tyre.

Pjesa tjetër e e-maileve u përcaktuan si jo në kompetencë të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit për trajtim. Në shumicën e tyre, nisur nga objekti dhe përmbajtja, ato u përcollën për trajtim pranë administratës tatimore për të shqyrtuar rastet dhe dhënë përgjigjet përkatëse për

informim apo asistencë të nevojshme të kërkuar. Të dhënat statistikore mbi trajtimin e tyre janë si më poshtë:

Ankesa/kërkesa të ardhura gjithsej në adresën elektronike:	296
nga këto:	
-Vlerësuar brenda objektit të fushës së përgjegjësisë së Avokatit të Tatimpaguesit:	26
→nga këto:	
a) të vijuar për trajtim:	15
b) të ndërprera:	11
-Të përcjella për trajtim pranë organeve tatimore (përfshirë dhe DPT):	102
-Të përcjella për trajtim pranë strukturave doganore (përfshirë dhe DPD):	6
-Ardhur nga zyra e bashkëqeverisjes dhe trajtuar:	42
-Trajtuar dhe dhënë përgjigje drejtpërdrejtë përsa lidhej objekti çështjes:	94
-Kaluar për kompetencë trajtimi strukturave të tjera brenda MFE:	26

Ç. Praktika të deleguara nga Drejtori i Përgjithshëm

Praktika gjithsej të deleguara:	128
nga këto	
-Vlerësuar brenda fushës së përgjegjësisë së Avokatit të Tatimpaguesit:	6
→nga këto:	
a) të vijuar për trajtim:	3
b) të ndërprera:	3
-Të përcjella për trajtim pranë administratës tatimore për kompetencë:	67
-Të përcjella për trajtim pranë administratës doganore për kompetencë	11
-Trajtuar në funksion të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Fiskale:	29
-Kaluar për kompetencë strukturave të tjera brenda MFE:	15

2. Baza e të dhënave

Është bërë përditësimi i bazës së të dhënave me praktikat e ardhura, sipas Manualit procedural të miratuar.

3. Promovimi i rolit të Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit

Në zbatim të nenit 105/2, paragrafi 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe pikës 3.1, shkronja “b”, të udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 6, datë 25.2.2019, “Për funksionet, autoritetin dhe përgjegjësitë e Avokatit të Tatimpaguesve, procedurat që do të zbatohen prej tij në mbrojtje të interesave të tatimpaguesve, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar mbrojtjen e të drejtave të tyre nga Avokati i Tatimpaguesve”, të ndryshuar, me qëllim promovimin e rolit të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesve, në muajin janar të vitit 2023, iu kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të mundësonte që në profilin e çdo tatimpaguesi në Republikën e Shqipërisë, në sistemin informatik tatimor “e-filing”, të shfaqej një mesazh në përmbajtje të të cilit të shprehej se:

Tatimpaguesit mund të kontaktojnë Drejtorinë e Avokatit të Tatimpaguesit në rrugë elektronike (nëpërmjet e-mailit Avokati.Tatimpaguesit@financa.gov.al) lidhur me çdo problematikë shqetësuese që mund të hasin në marrëdhëniet e tyre me administratën tatimore, që lidhet me shkeljen e të drejtave të tyre, procedurave tatimore, si dhe parimeve të administrimit tatimor, të parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Siç edhe kemi shpjeguar më lart, gjatë vitit 2023 në adresën e postës elektronike të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit u paraqitën **296** e-maile me problematika të ndryshme, nga të cilat u morën në shqyrtim brenda kompetencës dhe fushës së përgjegjësisë **26** prej tyre. Pjesa tjetër e e-maileve u përcaktuan si jo në kompetencë të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit për trajtim. Në shumicën e tyre, nisur nga objekti dhe përmbajtja, ato u përcollën për trajtim pranë administratës tatimore për të shqyrtuar rastet dhe dhënë përgjigjet përkatëse për informim apo asistencë të nevojshme të kërkuar.

Duke qenë se fluksi i e-maileve të ardhura në adresën e postës elektronike të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit për një periudhë të shkurtër, ishte përtej mundësisë së trajtimit të tyre nëse do të vijohej të mbetej i publikuar mesazhi, bazuar në kapacitetet aktuale të burimeve njerëzore të kësaj drejtorie (me 2 specialistë), si dhe duke qenë se u përmbush qëllimi i promovimit të rolit të Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesit, iu kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që shfaqja e mesazhit të ndërpritej dhe të bëhej në mënyrë periodike, për 10 ditë çdo 6 muaj.

4. Mbi inspektimet e parashikuara për t’u kryer pranë organeve tatimore gjatë vitit 2023

Pavarësisht nga miratimi prej ministrit përgjegjës për financat të programit të monitorimit procedural dhe të të drejtave të tatimpaguesve, i programuar për vitin 2023, realizimi i tij nuk u mundësua për arsye objektive që nuk vareshin nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit.

Sidoqoftë, për të vlerësuar trajtimin nga administrata tatimore për rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2023 dhe të vlerësuara si të zbatueshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në fund të muajit nëntor 2023 Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit përgatiti pyetësorë specifikë në formë anketimi për drejtoritë rajonale tatimore dhe strukturat rajonale të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara. Pyetësorët reflektonin problematikën e evidentuar gjatë shqyrtimit të çështjeve të ankimuara, rekomandimet për zgjidhjen e tyre dhe si procedohej praktikisht për rastet konkrete nga strukturat përkatëse për rastet e ngjashme. Përgjigjet për kthimin e pyetësorëve ishin lënë të ktheheshin brenda muajit dhjetor 2023, afat që nga ana e administratës tatimore u respektua. Për problematikën e evidentuar në përgjigjet e marra konkluzionet janë konkretisht si më poshtë:

A. Për drejtoritë Rajonale Tatimore Tatimore (“DRT”):

Nga përgjigjet e ardhura konstatohet se:

1) Për asistencën dhe informimin e tatimpaguesve mbi legjislacionin e miratuar për tatimin mbi të ardhurat:

a) Jo të gjitha DRT-të kanë materiale përmbledhëse të përgatitura për informimin e tatimpaguesve, që shpjegojnë zbatimin e legjislacionit përkatës (raporti: 5 po dhe 9 jo).

b) Jo të gjitha DRT-të kanë zhvilluar trajnime specifike për çështje që lidhen me zbatimin e legjislacionit përkatës për tatimin mbi të ardhurat (raporti 6 po dhe 8 jo).

2) Mbi afatet e parashikuara për kthimin e përgjigjeve tatimpaguesve për nevoja informimi dhe asistencë për çështje të ndryshme të zbatimit të legjislacionit tatimor:

a) DRT-të nuk kanë informacion të qartë mbi afatet që duhen respektuar për kthimin e përgjigjeve.

b) 3 nga DRT-të pranojnë që nga DPT ka një udhëzim lidhur me afatet që duhen respektuar, ndërkohë që pjesa tjetër nuk kanë dijeni mbi ekzistencën e një udhëzimi të tillë.

c) Pjesa më e madhe e DRT-ve pohojnë se përgjigjet kthehen jo më vonë se 10 ditë nga ardhja e kërkesës me shkrim ose elektronike. Dominojnë përgjigjet në afatet 3 - 7 ditë.

3) Mbi afatet për zbatimin e vendimeve të Apelimit Tatimor:

a) Dominojnë përgjigjet për periudhat 7 deri 10 ditë.

b) Nuk ka ndonjë udhëzim nga DPT lidhur me afatet për zbatimin e vendimeve të Apelimit Tatimor.

c) nga DRT-të përgjigjen vetëm 2 DRT që kanë nxjerrë urdhra të brendshëm për afatin që duhet zbatuar lidhur me rastin e vendimeve të Apelimit Tatimor.

4) Lidhur me ankesat e tatimpaguesve për penalitetet që gjenerohen nga sistemi C@TS, jo për përgjegjësi të tyre apo dhe të administratës tatimore (gabime sistemi) procedurat që zbatojnë DRT-të:

a) DRT-të nuk vetëveprojnë për sistemimin e gabimeve të tilla. Vetëm 2 DRT përgjigjen se ndërhyjnë vetë për sistemimin e gabimeve të tilla.

b) Pjesa më e madhe e DRT-ve orientojnë zgjidhjen e problematikës pranë DPT-së (gjithsej 9) dhe Apelimit Tatimor (gjithsej 11).

c) Nuk ka një udhëzim të brendshëm as nga DPT dhe as nga DRT-të se si duhet proceduar në raste të tilla për zgjidhjen e shqetësimit të tatimpaguesve.

5) Për procedurat e kontrollit tatimor, në të tre format e ushtrimit të tij:

a) Për kontrollin nga zyra dhe vizitat fiskale:

- Nuk ka zbatim uniform nga të gjitha DRT-të të procedurave të kontrollit tatimor të parashikuara në nenet 83 dhe 84 të ligjit procedural tatimor.

- Nga DRT-të, dy shprehen se nuk nxirret Raport Kontrolli (paraprak), dy shprehen se nuk nxirret Raport Përfundimtar Kontrolli.

b) Për kontrollin e thelluar në vend:

- Të gjitha DRT-të respektojnë procedurat e kontrollit tatimor të parashikuara në nenet 83 dhe 84 të ligjit procedural tatimor.

c) Lidhur me pranimin nga organi tatimor të kundërshtimit të raportit të kontrollit të shprehur nga tatimpaguesi dhe afatin e dorëzimit të kundërshtimit pranë DRT-së:

- Disa nga DRT-të (gjithsej 4, përfshi dhe DTM) pohojnë se e pranojnë kundërshtimin e shprehur nga tatimpaguesi ndaj Raportit të Kontrollit edhe gjatë periudhës së hartimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, për të konsideruar pretendimet që mund të qëndrojnë në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar.

- Vlerësojmë se në rastet kur kundërshtimi i tatimpaguesit ndikon në rezultatin e kontrollit, që mund të reflektohet edhe në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, DRT duhet ta pranojnë dhe t'i

konsiderojnë pretendimet e tatimpaguesit, për të shmangur procedurat e zgjatura, që lindin nga nevoja për shqyrtimin administrativ nga struktura e apelimit tatimor pas nxjerrjes së Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

B. Për Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP)

1. Mbi manualin procedural të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara:

a) Të tre drejtoritë rajonale përkatëse përgjigjen se e disponojnë një manual të tillë të miruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve - ***Nuk jemi në gjendje të verifikojmë saktësinë e përgjigjes.***

b) Të tre drejtoritë rajonale përkatëse shprehen se janë në dijeni të botimit në faqen Web të DPT, të manualit procedural të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara - ***Praktikisht në faqen zyrtare Web të DPT-së nuk ka të botuar një manual të tillë.***

c) Të tre drejtoritë shprehen se tatimpaguesit nuk duhet të njihen me manualin procedural të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, pasi ky manual është për përdorim të brendshëm. - ***Legjislacioni tatimor kërkon botimin e manualeve procedurale për njohje nga tatimpaguesit të procedurave përkatëse zbatuese, duke vlerësuar tatimpaguesit dhe administratën tatimore partnerë në zbatimin e tij.***

2. Mbi procedurat që zbatohen për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara:

a) Përgjithësisht nga përgjigjet për pyetjet mbi procedurat që ndiqen për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara rezultojnë të jenë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse - Rastet e veçanta të trajtuara nga Avokati i Tatimpaguesit për shkelje procedurash, mbeten sporadike, të cilat lidhen më së shumti me:

i. veprime/mosveprime të punonjësve tatimorë në përputhje me afatet procedurale të parashikuara, për të cilat vlerësimi si i qëllimshëm ose jo, është lënë për t'u vlerësuar nga titullari i nëpunësve përkatës;

ii. paqartësi në kuptimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, për të cilat janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse për zgjidhje;

iii. mungesa e parashikimeve në legjislacionin tatimor të disa afateve procedurale për kthim përgjigjesh mbi raste të veçanta të trajtimit të kërkesave/ankesave ndaj fillimit të procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara;

iv. mungesa e aktit nënligjor të parashikuar në pikën 4, të nenit 96, të ligjit procedural tatimor, për të cilin është lënë rekomandim për DPT-në hartimi i draftit përkatës.

Në përfundim, përsa kemi trajtuar në pikën 5, theksojmë se legjislacioni tatimor lidhur me monitorimin pranë strukturave tatimore, ka parashikuar verifikimin e zbatimit të procedurave në vend, duke iu referuar rasteve konkrete të zbatuara, nga praktika me përzgjedhje që lidhen me trajtimin e çështjeve specifike nga organet tatimore në përputhje me rekomandimet e dhëna. Marrja e përgjigjeve pohuese/mohuese nëpërmjet pyetësorëve, pa verifikuar dhe përgjegjësinë e organeve tatimore në zbatimin e procedurave konkrete të rekomanduara, nuk mund të konsiderohet e saktë, përse kohë nuk jemi në gjendje të verifikimit në vend mbi përgjigjet e dhëna, apo në shmangien e lapsuseve në ndonjë rast të mundshëm, në vlerësimin tonë teorik të konstatuar si të tillë.

5. Mbi rekomandimet e Avokatit të Tatimpaguesit të lëna mbi bazën e vlerësimeve nga analiza e veprimtarisë së tij në Raportin për gjashëmujorin e parë të vitit 2023 dhe konsiderimin e tyre nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Rekomandimi 1: Ankimi drejtpërdrejtë pranë DRT-së për penalitete të paparashikuara në legjislacionin tatimor, që vijnë për shkak të problemeve të vetë sistemit informatik tatimor (jo për faj apo gabime të tatimpaguesit) dhe organi tatimor të kryejë vetë sistemimin e penalitetit të gabuar në sistemin tatimor, duke eliminuar procedurën e apelimit tatimor për raste të tilla.

Ky rekomandim nuk është pranuar, pasi në vlerësimin e DPT-së, duhet bërë rregullim ligjor, për të autorizuar organet tatimore të procedojnë për sistemimin e gabimeve të tilla në sistemin informatik tatimor.

Rekomandimi 2: Në kuadër të hyrjes në fuqi të ligjit të ri “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe informimit të tatimpaguesit për procedurat zbatuese të parashikuara në ligj dhe me akte nënligjore, Administrata Tatimore:

i. të përgatisë materiale orientuese përmbledhëse për tatimpaguesit, bazuar mbi temën e trajnimit për tatimin mbi të ardhurat, për të ndihmuar tatimpaguesit për të kuptuar dhe zbatuar me korrektësi legjislacionin përkatës.

ii. të ofrojë në vazhdimësi për tatimpaguesit apo kategori tatimpaguesish, edhe zhvillim seminaresh të shkurtra trajnimi për çështje të veçanta të fushës për tatimin mbi të ardhurat, bazuar edhe në problematikat e konstatuara apo që mund të konstatohen në vijim gjatë zbatimit të legjislacionit përkatës.

Ky rekomandim është pranuar nga DPT dhe jemi informuar se ka filluar zbatimi i tyre. Nga vlerësimi sipas Pyetësorit të përgatitur nga Avokati i Tatimpaguesit (informacion më i detajuar jepet në analizën e dhënë në pikën 5, të këtij Raporti), në përgjigjet e dhëna nga organet tatimore rezulton se ende ka probleme me:

i. përgatitjen e materialeve informuese për tatimpaguesit;

ii. zhvillimin e seancave trajnuese (seminare të shkurtra) për çështjet më problematike të evidentuara.

- Sidoqoftë ky rekomandim vlen në vazhdimësi dhe organet tatimore janë të angazhuara duke vepruar për zbatimin e tij.

Rekomandimi 3: Publikimi i manualeve proceduriale në faqen Web të DPT-së, në zbatim të nenit 135 të ligjit procedural tatimor.

Ky rekomandim është vlerësuar nga DPT, por ende në faqen e saj Web nuk ka të botuara manualet proceduriale sipas fushave të përgjegjësisë në zbatimin e legjislacionit tatimor. Përjashtim nga botimi, për shkak të natyrës dhe sekretit, bën vetëm manuali i hetimit tatimor.

Rekomandimi 4: Nxjerra e Udhëzimit të përbashkët MFE dhe MD, në zbatim të pikës 4, të nenit 96, të Ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ky rekomandim është konsideruar nga DPT, e cila përse ka bërë me dije, ka përgatitur draftin e udhëzimit, të cilin e ka përcjellë për mendim pranë strukturave përkatëse në ministrinë përgjegjëse për financat.

Çështjet e vlerësuara dhe klasifikuara me problematikë nga shqyrtimi i kërkesave/ankesave gjatë vitit 2023, dhe rekomandimet e nxjerra, janë si më poshtë:

5.1 Mbi zbatimin e procedurave dhe të drejtës për t'u dëgjuar të tatimpaguesit në rastet e ndryshimit të përgjegjësisë tatimore.

Referuar ankesave të paraqitura pranë Avokatit të Tatimpaguesit, në rastet kur, nga një kontroll i ushtruar nga administrata tatimore rezulton se tatimpaguesi ka plotësuar kushtet për ndryshim të përgjegjësisë tatimore, kjo e fundit bën menjëherë ndryshimin dhe njofton tatimpaguesin për ndryshimin e përgjegjësisë sipas rastit.

Në vlerësim të aktit të njoftimit për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore drejtuar tatimpaguesit, ky i fundit thirret për të marrë informacion pas marrjes së vendimit për ndryshim të përgjegjësisë tatimore. Avokati i Tatimpaguesit, lidhur me elementët e aktit administrativ, ka konstatuar, se:

- Akti i njoftimit për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore, i cili nxirret në formë të shkruar, nuk ezauron tërësinë e elementëve që duhet të përmbajë një akt administrativ. Përmbajtja e njoftimit, kufizohet vetëm në bazën ligjore në referencë të së cilës ndryshon përgjegjësia tatimore e tatimpaguesit, duke shmangur pjesën shpjeguese dhe arsyetuese mbi situatën faktike të tatimpaguesit në momentin e ndryshimit të përgjegjësisë tatimore. Njëkohësisht, akti i njoftimit nuk përcakton informacionin mbi mjetet ligjore të tatimpaguesit për kundërshtimin/ankimin e vendimit të nxjerrë nga organi tatimor.

- Gjithashtu, lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, pas nxjerrjes së aktit të njoftimit për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore, Avokati i Tatimpaguesit ka vlerësuar edhe dy problematika në procedurat që aktualisht zbatohen në praktikë:

a) *Së pari*, e drejta për t'u dëgjuar përpara marrjes së një vendimi përfundimtar, është një element i të drejtave themelore të tatimpaguesit e parashikuar shprehimisht në nenin 37 të ligjit nr. 9920/2008, të ndryshuar si dhe rregullat e përgjithshme të shqyrtimit administrativ të parashikuara në ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë". Kjo e drejtë themelore procedurale, korrespondon me detyrimin e administratës për të informuar tatimpaguesin mbi këtë të drejtë e cila duhet të ezaurohet përpara marrjes së një vendimi përfundimtar ndaj tatimpaguesit, në mënyrë që këtij të fundit, t'i mundësohet pjesëmarrja në procedurë administrative dhe ezaurimi për të mbrojtur të drejtat dhe interesat nëpërmjet paraqitjes së fakteve dhe argumenteve përpara marrjes së vendimit. Moszbatimi nga administrata tatimore i detyrimit për të dëgjuar tatimpaguesin përpara marrjes së vendimit përfundimtar, sjell si pasojë edhe paligjshmërinë e aktit administrativ.

b) *Së dyti*, thirrja dhe komunikimi verbal ndërmjet tatimpaguesit dhe nëpunësit të administratës tatimore, për të marrë sqarime dhe mbi të gjitha për të orientuar tatimpaguesin mbi të drejtën e ankimit të aktit administrativ të nxjerrë jo në favor të tij (pra që prek interesat dhe pasurinë e tatimpaguesit), përbën shkelje të rregullave të etikës së zyrtarit, për sa kohë çdo tatimpagues gëzon të drejtën e trajtimit profesional dhe etik. Një marrëdhënie verbale komunikimi, jo vetëm që cënon të drejtën e tatimpaguesit për t'u mbrojtur, por njëkohësisht ndikon në besimin e tatimpaguesve në aspektin e ligjshmërisë, objektivitetit, ndihmës dhe efencës gjatë vendimmarrjes së administratës publike.

Rekomandime përgjithësuese për ndryshim akti nënligjor.

Për sa më lart, propozojmë përcaktimin e dispozitave procedurale në Udhëzimin procedural tatimor, për rastet e ndryshimit të përgjegjësisë tatimore, ku të përcaktohet detyrimi për njoftim i tatimpaguesit nga ana administratës tatimore brenda një afati procedural përpara marrjes së vendimit për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore.

DPT të unifikojë aktet e njoftimit për rastet e ndryshimit të përgjegjësisë tatimore duke kunsideruar të gjithë elementët e detyrueshëm të një akti administrativ, me qëllim plotësimin tërësor të të drejtës së tatimpaguesit mbi mjetet ligjore të mbrojtjes, si dhe mundësisë për të marë informacionin e plotë mbi arsyet dhe shkaqet e marrjes së vendimit nga organi tatimor.

5.2 Mbi procedurat e zbatuara në rastet e të drejtës së tatimpaguesit për të paraqitur Observacion/dokumentacion si pjesë e tij, gjatë ushtrimit të kontrollit tatimor nga administrata tatimore.

Nga rastet e paraqitura në Drejtorinë e Avokatit të Tatimpaguesit, është vërejtur se, gjatë zhvillimit të procedurave të kontrollit tatimor, tatimpaguesi, për raste të caktuara dhe arsye objektive të pretenduara, nuk ka paraqitur brenda afatit procedural 15 ditor, kundërshtimin e rezultateve të kontrollit, ku parashtrohen pretendimet mbi raportin e kontrollit të nxjerrë nga organi tatimor. Tatimpaguesi, ka parashtruar shkaqe të arsyeshme për dorëzimin përtej afatit procedural të dokumentacionit që shoqëron kundërshtimin e tij, gjë që për rrethana të caktuara e detyron atë që dokumentet provuese të dorëzohen brenda afatit të shqyrtimit dhe nxjerrjes së raportit përfundimtar të kontrollit. Organi tatimor, për shkak të tejkalimit të afatit ligjor 15 ditor, nuk ka vlerësuar shkaqet e vonës në dorëzimin e dokumentacionit, dhe nuk ka pranuar dokumente të cilat sipas tatimpaguesit ndikojnë në mënyrë thelbësore në vlerësimin e detyrimit të caktuar nga organi tatimor.

Në këto kushte tatimpaguesi, për shkak të humbjes së afatit të përcaktuar në ligj, ka humbur të drejtën për të ezauruar një mbrojtje të plotë, në këtë shkallë të shqyrtimit administrativ. Nga pyetësorët e shpërndarë në Drejtoritë Rajonale Tatimore, mbi zbatimin e të drejtës së tatimpaguesit dhe procedurës në këtë rast, është konstatuar se:

- a) Disa nga DRT-të (gjithsej 4, përfshi dhe DTM) pohojnë, se e pranojnë kundërshtimin e shprehur nga tatimpaguesi ndaj Raportit të Kontrollit edhe gjatë periudhës së hartimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, për të konsideruar pretendimet që mund të qëndrojnë në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar.
- b) Vlerësojmë se në rastet kur kundërshtimi i tatimpaguesit ndikon në rezultatin e kontrollit, që mund të reflektohet edhe në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, DRT duhet ta pranojnë dhe t'i konsiderojnë pretendimet e tatimpaguesit, për të shmangur edhe procedurat e zgjatura, që lindin nga nevoja për shqyrtimin administrativ nga struktura e apelimit tatimor pas nxjerrjes së Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Rekomandim përgjithësues për ndryshim ligjor.

Parë në aspektin e shqyrtimit të plotë dhe tërësor nga administrata tatimore të të gjitha fakteve dhe provave të disponuara të paraqitura nga tatimpaguesi por dhe eficencës së administratës tatimore në nxjerrjen e vendimeve të arsyetuara dhe bazuara në të gjitha provat dhe faktet e paraqitura nga pala, vlerësojmë se, do të ishte e nevojshme përfshirja në ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të të drejtës së tatimpaguesit për

paraqitjen e kërkesës së justifikuar për shtyrje të afatit procedural të dorëzimit të dokumentacionit (për sa kohë afati procedural është i prerë dhe i parashikuar në ligj, edhe e drejta për shtyrje të afatit duhet të përcaktohet në ligj).

Duke vlerësuar dhe efencën procedurale në nxjerrjen e raportit përfundimtar nga administrata tatimore, kërkesa për shtyrje afati procedural për paraqitjen e observacionit nga tatimpaguesi, të kryhet brenda afatit përfundimtar procedural për dorëzimin e observacionit, edhe gjatë periudhës së hartimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit. Por kushti të jetë që shtyrja e afatit të kërkuar nga tatimpaguesi të mos ndikojë në çdo rast në tejkalimin e afatit maksimal të nxjerrjes së Raportit Përfundimtar të Kontrollit nga administrata tatimore.

5.3 Problematika të shfaqura për rastet e zbatimit procedural në vonesë nga administrata tatimore të kërkesave të tatimpaguesve për rimbursim të tepërcave kreditore dhe marrëveshjeve të pagesës me këste.

Nga rastet e paraqitura pranë Avokatit të Tatimpaguesit, me objekt mos kthim përgjigje mbi marrëveshjet e pagesës me këste apo kërkesa për kompensim/ rimbursim, edhe pse të pakta, kanë rezultuar me vonesa nga organi tatimor në kthimin e përgjigjeve ndaj tatimpaguesit, edhe me justifikimin e parashikimit në ligj apo akt nënligjor të detyrimit të paraqitjes me shkrim nga tatimpaguesi të kërkesës. Theksojmë se, me ndërhyrjen e Avokati i Tatimpaguesit , si nga ana e drejtorive rajonale ashtu dhe DPT rastet janë zgjidhur.

Për raste të tilla, vlerësojmë se, për të shmangur vonesat të cilat justifikohen nga organi tatimor edhe për shkak të formës së paraqitjes së kërkesës me shkrim nga tatimpaguesi (rimbursim/ marrëveshje pagesë me këste), të rishikohen në aspektin e zbatimit të formës dhe mënyrës së komunikimit, dispozitat e parashikuara në nenet 75, “Detyrime tatimore të paguara më tepër” pika 1, gërma “a”, si dhe 77, “Marrëveshja e pagesës me këste”, pika 2. Këto dispozita parashikojnë detyrimin e tatimpaguesit për të paraqitur *me shkrim* miratimin në rastin e kompensimit të detyrimeve të tjera tatimore apo rimbursimit të detyrimeve të paguara më tepër, apo paraqitjen e kërkesës me shkrim për lidhjen e një marrëveshje të pagesës me këste.

Në këndvështrimin e Avokatit të Tatimpaguesit, duke konsideruar dhe rregullat e parashikuara në dispozitat e përgjithshme administrative të komunikimit me personat e tatueshëm në nenin 23 të ligjit procedural tatimor si dhe pikës 23.3.4 të Udhëzimit të ministrit të Financave për zbatimin e kësaj dispozite, kërkesa me shkrim konsiderohen edhe ato të paraqitura në formë elektronike, në adresën elektronike zyrtare të institucionit. Për sa kohë, ligji procedural nuk e kushtëzon paraqitjen e kërkesës apo miratimit me shkrim me dërgimin në rrugë postare, kërkesa nuk konsiderohet me të meta dhe për pasojë duhet të pranohen në adresë elektronike zyrtare nga administrata tatimore, si për rastin e lidhjes të marrëveshjes së pagesës me këste ashtu dhe ato për të cilat tatimpaguesi jep miratim për kompensim të detyrimeve tatimore të paguara më tepër.

Mjeti i komunikimit elektronik të pranuar në këto raste, duke vlerësuar dhe frymën e legjislacionit në përgjithësi, do të lehtësojë kontaktin e tatimpaguesit me administratën tatimore dhe njëkohësisht do të garantojë akses më të lehtë në përmbushjen e detyrimeve prej saj.

Rekomandim.

Për rastet e kërkesave të tatimpaguesve për të përfutur nga rimbursimi apo marrëveshja e pagesës me këste, rekomandojmë që DPT të nxjerrë një Udhëzues sipas të cilit drejtoritë rajonale tatimore të njohin dhe ndjekin kërkesat e tatimpaguesve të paraqitura në rrugë elektronike për

rastet e rimbursimit apo të drejtës për të lidhur marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve tatimore të papaguara.

5.4 Lidhur me aspektin procedural të shqyrtimit të penaliteteve të vendosura tatimpaguesve.

Nga praktikat administrative të shqyrtura nga Avokati i Tatimpaguesit, në disa raste ka rezultuar se, tatimpaguesi pavarësisht se ka zbatuar me korrektësi procedurat për deklarimin e detyrimeve të tij tatimore, si dhe ka kryer pagesën e tyre në afat, për gabime të sistemit informatik tatimor është penalizuar në mënyrë automatike me gjoba. Praktikisht, këto gjoba, nuk janë të parashikuara në legjislacionin tatimor dhe për rrjedhojë edhe nuk duhet të njihen, pasi nuk janë pasojë e veprimeve/mosveprime të tatimpaguesit, të tilla që bien ndesh me legjislacionin tatimor.

Legjislacioni tatimor ka parashikuar të drejtën e tatimpaguesit të ndjekë procesin e ankimit administrativ kur nuk është dakord me vlerësimet/vendimet/penalitetet e vendosura nga organi tatimor. Për këtë qëllim, Kreu XIII i Ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar procedurat që ndiqen nga tatimpaguesi në të drejtën e tij të ankimit administrativ, duke iu drejtuar së pari Drejtorisë së Apelit Tatimor (“DAT”) dhe, më tej, të ankimit gjyqësor, kur mendon se vendimi i DAT nuk kënaq pritshmërinë e tij.

Në kushtet kur sistemi elektronik tatimor, për shkak të problemeve të shfaqura, gjeneron gjoba të lindura jo si pasojë e shkeljeve të tatimpaguesit, duhet të vlerësohet heqja e tyre me procedurë të përjashtuar nga procedura e ankimit administrativ të parashikuar në Kreun XIII të ligjit procedural tatimor. Në këto raste, kur një gabim i tillë konstatohet, DRT mund dhe duhet të veprojë kryesisht, duke ndërhyrë për të sistemuar gjobat e gjeneruara gabim nga sistemi. Ose, kur vetë tatimpaguesi konstaton një gabim të tillë, ai të ankimojë pranë DRT-së përkatëse, për të ndërhyrë dhe sistemuar gabimin e shfaqur nga sistemi, për penaltetin/penalitetet e gjeneruara në mënyrë automatike jo për faj të tij.

Rekomandim:

Mendimi i Avokatit të Tatimpaguesit është se parë në aspektin procedural, shqyrtimi dhe marrja e një vendimi nga vetë organi tatimor qoftë kryesisht, qoftë edhe me kërkesë të tatimpaguesit, jo vetëm që lehtëson tatimpaguesin, por dhe shmang procedurat e tejzgjatura të ankimit administrativ, apo edhe gjyqësor (për pavlefshmëri absolute të penaltetit të marrë). Po kështu, veprimi kryesisht nga organi tatimor, do të garantonte njëkohësisht besimin e tatimpaguesit të administratës tatimore për shqyrtimin dhe zgjidhjen në afate të shkurtra kohore në mënyrë të drejtë dhe objektiv të një problemi të tillë. Kjo procedurë është konform dhe nenit 113 të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, sipas të cilit, akti administrativ, mund të anulohet kryesisht nga vetë organi që ka nxjerrë aktin.

Lidhur me këtë rekomandim, i cili është propozuar 6 mujorin e parë të vitit, DPT ka kërkuar ndryshim ligjor për dhënien e kompetencës Drejtorive Rajonale Tatimore për të vepruar kryesisht dhe hequr penaltetet e lindura jo për faj të tatimpaguesve.

5.5 E drejta për informim dhe asistencë, mbi zbatimin e legjislacionit procedural tatimor, specifikisht ligjit nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe publikimit të manualeve procedurale, sipas detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 135 të ligjit nr. 9920/2008, i ndryshuar.

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit, kërkesat mbi sqarime dhe informim për zbatimin e legjislacionit tatimor nga tatimpaguesit drejtuar administratës tatimore, të cilat nuk kanë marrë përgjigje, kanë qenë të konsiderueshme. Me ngritjen e problematikës në raportin drejtuar DPT, për periudhën, në vijim kemi konstatuar një ulje të ndjeshme të numrit të ankesave me problematikë të këtij lloji.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, për shkak të ndryshimeve të qënësishme në përmbajtjen e kësaj pakete normash, u vlerësua ndërhyrja e AT, për angazhimin e administratës tatimore, në aspektin e njohjes nga tatimpaguesit të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në këtë akt. Lidhur me këtë fakt, për DPT, gjatë 6 mujorit të parë, janë lënë rekomandimet si më poshtë:

- i. përgatitja e materialeve orientuese përmbledhese për tatimpaguesit, bazuar mbi temën e trajnimit për tatimin mbi të ardhurat, për të ndihmuar tatimpaguesit për të kuptuar dhe zbatuar me korrektësi legjislacionin përkatës.
- ii. ofrimi në vazhdimësi për tatimpaguesit apo kategori tatimpaguesish, dhe zhvillimin e seminareve të shkurtra trajnimi për çështje të veçanta të fushës për tatimin mbi të ardhurat, bazuar edhe në problematikat e konstatuara apo që mund të konstatohen në vijim gjatë zbatimit të legjislacionit përkatës.

Këto rekomandime janë pranuar nga DPT dhe jemi informuar se ka filluar zbatimi i tyre. Nga vlerësimi sipas Pyetësorit të përgatitur nga Avokati i Tatimpaguesit (informacion më i detajuar jepet në analizën e dhënë në pikën 5, të këtij Raporti), në përgjigjet e dhëna nga organet tatimore rezulton se ende ka probleme me:

- i. përgatitjen e materialeve informuese për tatimpaguesit;
- ii. zhvillimin e seancave trajnuese (seminare të shkurtra) për çështjet më problematike të evidentuara.

Sidoqoftë ky rekomandim vlen në vazhdimësi dhe organet tatimore duhet të jenë të angazhuara në vijimësi, për zbatimin e tij.

5.6 Procedurat e ndjekura nga administrata tatimore në rastet e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara.

Në rastet e trajtuara nga Avokati i Tatimpaguesit, në disa nga çështjet, Avokati i Tatimpaguesit ka konstatuar të drejtë ankesën e tatimpaguesit, duke kërkuar nga administrata tatimore të reagojë, duke pritur përfundimin e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor. Në një rast, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Avokati i Tatimpaguesit ka konstatuar të drejtë veprimin e administratës tatimore për procedurën e mbledhjes me forcë të filluar ndaj tatimpaguesit, edhe pse ai kishte ndjekur rrugën gjyqësore, duke vlerësuar se procedurat e ndjekura nga tatimpaguesi binin në kundërshtim me dispozitat ligjore të ankimit.

Administrata tatimore, në disa raste, në nxjerrjen e aktit administrativ Urdhër Bllokimi të llogarive bankare të personit juridik, ka përfshirë njëkohësisht dhe bllokimin e llogarive bankare personale të administratorit, duke transferuar njëherësh përgjegjësinë për detyrimet e papaguara të personit juridik edhe të administratori, në kundërshtim me sa ligji dhe udhëzimi kanë parashikuar. Administrata tatimore ka justifikuar veprimet e ndërmarra, bazuar në nevojën e maksimizimit të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, por procedura e zbatuar është keqinterpretim dhe zbatim i gabuar i neneve 90 dhe 99 të ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat

tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikës 90.1 dhe 99.1 të Udhëzimit nr. 24/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke transferuar përgjegjësinë për mbledhjen e detyrimeve tatimore administratorit të personit juridik.

Në rastin e paraqitur, edhe pse të argumentuar, nga DPT nuk është konsideruar rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesit, duke vijuar me zbatimin jo të drejtë të procedurës së filluar ndaj administratorit të personit juridik.

Vihet re se ka vonesa administrative të paarsyeshme të inspektorëve, në fazën procedurale të zhbllokimit të llogarive bankare pas pagimit të detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit. Theksojmë se strukturat e mbledhjes me forcë, kanë reaguar pas ndërhyrjes së Avokatit të Tatimpaguesit, në zgjidhjen e rasteve.

Propozim për nxjerrje akti nënligjor.

Nxjerrja e Udhëzimit të përbashkët MFE dhe MD, në zbatim të pikës 4, të nenit 96, të Ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky rekomandim është pranuar, pasi DPT ka propozuar nxjerrjen e aktit nënligjor të rekomanduar nga Avokati i Tatimpaguesit, draft i cili është në procedurë shqyrtimi për marrje mendimi.

Pavarësisht nga vlerësimet e Avokatit të Tatimpaguesit për rastet e ankimuara dhe kërkesave për rishqyrtimin e vendimeve të rastit, përgjigjet e dhëna nga administrata tatimore tregojnë se nga strukturat e mbledhjes, si ato rajonale por edhe pranë DPT-së, nuk e kanë të qartë kuptimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore që lidhen me kalimin e përgjegjësisë ortakut, aksionarit dhe administratorit, në kuptim të nenit 99 të ligjit.

DPT të nxjerrë një shkresë sqaruese për të gjithë strukturat e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, mbi sqarimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore për të gjitha rastet përpara hyrjes në fuqi të Udhëzimit nr. 45/2020.

5.7 Procedurat për rastet e detyrimeve tatimore të paguara më tepër.

Në rastet e kërkesave për rimbursim, ku tatimpaguesit kanë rezultuar me tepricë kreditore, dhe sistemi automatik, ka kaluar për llogari të detyrimeve të papaguara tatimore, shuma e mbetur e cila sipas kërkesës me shkrim, duhet të rimbursohet (kthehet) apo kalohej për llogari të detyrimeve të ardhshme tatimore, nuk është kryer, me arsyetimin se tatimpaguesi nuk kishte paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore. Nga zbatimi i këtyre rasteve, është konstatuar se, tatimpaguesi, edhe pas pagimit të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara, veprim i cili kryhet automatikisht nëpërmjet sistemit, kur rezulton ende me tepricë kreditore, për shkak se sistemi tatimor i detyrimeve është i veçuar nga pagesa e detyrimeve të kontributit të sigurimeve shoqërore, tatimpaguesi nuk rimbursohet për arsye të mospagimit të këtyre detyrimeve.

Rregullat procedurale për rastet e detyrimeve tatimore të paguara më tepër, janë parashikuar në nenin 75 të Ligjit nr. 9920/2008, të ndryshuar, dhe pikës 75/1.1 të Udhëzimit nr. 24/2008 për rastin e kërkesave për rimbursim të TVSH si dhe 75.1 të po këtij udhëzimi për rastet e kërkesave për rimbursim të detyrimeve të tjera tatimore.

Neni 75, pika 3 e ligjit, përcakton se: “*Kompensimi nga teprica kreditore e detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore,*

kryhet automatikisht nga sistemi informatik”. Ndërkohë që, shuma e mbetur, nëse ka, pas kalimit të shumës së paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara, sipas ligjit, duhet të rimbursohet brenda 30 ditësh nga momenti i paraqitjes së kërkesës me shkrim të tatimpaguesit.

Praktikisht, kompensimi nga teprica kreditore e detyrimeve tatimore, nuk mund të realizohet në sistem për llogari të detyrimeve të sigurimeve shoqërore. Në kuptim dhe interpretim të kësaj dispozite, teprica kreditore nuk mund të kalojë për llogari të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore, por vetëm për pagesat e detyrimeve të tjera tatimore. Për pasojë, tatimpaguesi, edhe pse është në kushtet e tepricës kreditore, nuk mund të rimbursohet pa paguar më parë detyrimet e sigurimeve shoqërore. Përtej faktit të dispozitave ligjore, dhe rregullat e parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 24/2008, të ndryshuar, në zbatim kryesisht të pikës 75.1, por dhe 75.1/1, nuk përcaktojnë dispozita të qarta dhe të detajuara mbi detyrimin e tatimpaguesit për pagimin e kontributit të sigurimeve shoqërore *përpara rimbursimit* apo kalimit të tepricës kreditore për llogari të detyrimeve të ardhshme tatimore.

Propozim për ndryshim në Udhëzimin nr. 24/2008, të ndryshuar.

Në këndvështrimin e Avokatit të Tatimpaguesit, si dhe në zbatim të parimit të hartimit të dispozitave ligjore në gjuhë të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshme, me qëllim qartësimin, kuptimin si dhe zbatimin e nenit 75 të ligjit, dispozitat procedurale të parashikuara në pikën 75.1 dhe 75.1/1, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24/2008, të ndryshuar, duhet të përcaktojnë qartësisht dhe shprehimisht, pagimin nga ana e tatimpaguesit, të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përpara rimbursimit/kalimit për llogari të detyrimeve të ardhshme të tatimpaguesit për rastet kur ky i fundit rezulton me tepricë kreditore. Ky rregullim, do të ndihmojë tatimpaguesit të qartësohen që e drejta për rimbursim garantohet pas pagimit të kontributit të sigurimeve shoqërore, duke siguruar përfitimin në kohë më të shpejtë të të drejtës për kompensim të parashikuar në ligj.

6. Detyra shtesë të kryera

- Hartimi i draft akteve për shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin dhe Manualin procedural të veprimtarisë së Avokatit të Tatimpaguesve.
- Përfaqësime në takime të niveleve të ndryshme në interes të Drejtorisë së Përgjithshme;
- Shqyrtim dhe trajtim të praktikave që lidheshin me zbatimin e politikave fiskale të ministrisë përgjegjëse të financave, përfshirë dhe ato të deleguara për kompetencë për t’u trajtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që lidhen me marrëdhëniet e tyre të drejtpërdrejta me tatimpaguesit, si organe ligjzbatuese;
- Çështje të tjera në interes të Drejtorisë së Përgjithshme, apo të ministrisë përgjegjëse për financat.

7. Propozime të dhëna për fillim procedimi disiplinor nga rastet e shqyrtuara

Nga shqyrtimi i çështjeve të trajtuara nga Avokati i Tatimpaguesit, në varësi të gjetjeve mbi shkelje procedurash që bien ndesh me të drejtat e tatimpaguesve, janë propozuar 3 (tre) raste për fillim procedimi disiplinor për punonjës tatimorë, nga të cilët në tre raste janë dhënë masa disiplinore, për përgjegjësi në rastet përkatëse.

8. Propozim për nxjerrje vendimesh teknike

Nga rastet e shqyrtuara gjatë vitit 2023, Avokati i Tatimpaguesit i ka propozuar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, nxjerrjen e vendimit teknik sipas nenit 10 të ligjit nr. 9920/2008, të ndryshuar, mbi:

- Zbatimin e nenit 59 “Pagesa me para në dorë”, të ligjit nr. 9920/2008, të ndryshuar, për rastet kur tatimpaguesit kanë kryer transaksione në rrugë bankare jashtë vendit, por nga administrata tatimore, kjo kategori transaksionesh nuk janë njohur dhe janë konsideruar si pagesa me para në dorë. Lidhur me këtë rast, DPT nuk ka nxjerrë një vendim teknik.
- Propozimin për rregullim ligjor, për trajtimin e këtyre rasteve.

9. Propozime mbi rishikimin e kompetencave të Avokatit të Tatimpaguesit të parashikuara në aktet nënligjore që rregullojnë organizimin, kompetencat dhe funksionimin e tij.

Kompetencat dhe funksionet e Avokatit të Tatimpaguesit, janë parashikuar në nenin 105/2 të ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Referuar dispozitave të parashikuara në këtë nen, Avokati i Tatimpaguesit autorizohet të investigojë kërkesat e tatimpaguesve që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosprespektimi i procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimore.

Referuar VKM-së nr. 648/2007, “Për Avokatin e Tatimpaguesit”, të ndryshuar, në pikën 3.1 parashikohet e drejta e Avokatit të Tatimpaguesit për monitorimin e procedurave administrative tatimore me synim mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesve, ndërkohë që, pika 3.1.1 e në vijim deri në pikën 3.1.9 referon vetëm në të drejtat e tatimpaguesit të parashikuara në Kreun IV, neni 30 e në vijim, të ligjit nr. 9920/2008, të ndryshuar. Propozojmë që, VKM-ja në dispozitat që parashikojnë fushën e kompetencës së Avokatit të Tatimpaguesit të parashikuar me ligj, të përcaktojë jo vetëm dispozitat për monitorimin e procedurave dhe shqyrtimin e të drejtave themelore të parashikuara në ligjin procedural tatimor, por për të gjitha të drejtat e parashikuara në legjislacionin procedural, si e drejta për rimbursim, e drejta për të lidhur marrëveshje të pagesës me këste për rastet kur tatimpaguesi është në paaftësi paguese, etj.

Gjithashtu, në VKM, propozojmë të ndryshojë shqyrtimi i kërkesave/ankesave për rastet e konstatimit të shkeljes së të drejtave të tatimpaguese në 2 (dy) shkallë, Drejtori Rajonale, dhe Drejtori e Përgjithshme, duke shmangur shqyrtimin nga Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm. Ky ndryshim do të shkurtojë afatet procedurale duke i ardhur në ndihmë tatimpaguesve për marrjen e një qëndrimi në afat sa më të shkurtër kohor.

Ju faleminderit!

31 Janar 2024

AVOKATI I TATIMPAGUESIT